



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1391
Datë: 16/ 6/ 2022

Mbështetur në nenin 17 të Kodit të Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës (Nr. 1/751, dt. 19/07/2013), sidomos dispozitave të neneve 6, 7 dhe 8 të Rregullores për Masat dhe Procedurat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës dhe Rregulloren e Punës të Këshillit të Etikës (Nr. 1/629, dt. 14/07/2016), Statutin e Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Etikës, njëzëri, në mbledhjen e mbajtur me datën 31.05.2022, mori këtë:

VENDIM

- Prof. ass. dr. Ardian Kastratit i caktohet masa ndëshkuese e mohimit të përfshirjes në mentorim në të gjitha nivelet e studimit në Universitetin e Prishtinës për tri vite nga data 31.05.2021. Kjo masë ka të bëjë vetëm me kandidatët e rinj dhe jo për kandidatët, të cilët tanimë janë në mentorim.
- Artikulli i referuar me këtë lëndë nuk konsiderohet më punim i botuar nga autori dhe nuk mund të shfrytëzohet për avancim akademik.

ARSYETIM

I. Bashkimi i lëndëve

Meqë kemi të bëjmë me të njëjtin artikull si objekt shqyrtimi sipas denoncimit është bashkuar lënda e denoncimit (Nr.Prot. 2/217, 01.10.2021) kundër Prof. Dugollit dhe Prof. Kastrati.

II. Paraqitja, vlerësimi dhe kualifikimi i të gjeturave faktike

- Me datë 1 Tetor 2021, Organizata 'ORCA' ka protokolluar dhe dorëzuar Paraqitje e shkeljes disiplinore për Prof. Dr. Bujar Dugollin dhe Prof. ass. dr. Ardian Kastratin. ORCA

L. M.

pretendon se dy profesorët e lartpërmendur kanë përdorur një punim me elemente të theksuara të plagjiaturës për tu avancuar në grada më të larta akademike. Punimi titullohet 'DIPLOMACY THROUGH THE AGES OF HISTORY: THEORETICAL ANALYSES OF THE CONCEPT' i publikuar në revistën ANALELE UNIVERSITATII DIN CRAIOVA-SERIA ISTORIE' e indeksuar në platformën SCOPUS që nga viti 2009. Sipas raportit të dal nga platforma TURNITIN (platformë për detektimin e ngjashmërive të punimeve), punimi ka indeks të ngjajshmërisë prej 70% prej së cilave 68% burime nga interneti, 18% punime shkencore).

Sipas ORCA, ky punim ka shërbyer për avancimin e Prof. asoc. Bujar Dugolli në Profesor të rregullt në konkursin me nr.1-173 të datës 27.04.2018. Ndërsa, në konkursin e datës 22.10.2019 për zgjedhjen e personelit akademik në Fakultetin Filozofik, ishte propozuar dhe avancuar Ardian Kastrati nga asistent në profesor asistent.

➤ Me datë 11 Nëntor 2021, me nr. protokolli 2/666, Prof. dr. Bujar Dugolli deponon përgjigjen kundrejt paraqitjes për shkelje disiplinore nga organizata ORCA. Profesori në fjalë hedh poshtë çdo dyshim dhe pretendim se punimi në fjalë është plagjiaturë. Profesori thekson se punimi për të cilin janë ngritur dyshimet është REVIEW PUNIM dhe dallon nga punimet shkencore. Sipas profesorit, punimi në fjalë nuk ka qenë pjesë e vlerësimit për avancimin e tij akademik. Poashtu ai pretendon se çdo paraqitje nga ORCA tejkalon afatet kohore të ligjshme për ankesa të rregulluara sipas rregulloreve në nivel të Universitetit të Prishtinës.

➤ Më 15 Nëntor 2021, Prof. ass. dr. Ardian Kastrati jep përgjigje përmes emailit kundrejt Paraqitjes për shkelje disiplinore nga organizata ORCA. Profesori Kastrati thekson:

"se paraqitja nuk ka të bëjë me pretendimet për botimin por me tendencën për ta persekutuar atë publikisht dhe politikisht. Sipas profesorit botimi është bërë sipas të gjitha kërkesave dhe standardeve të aplikuara nga redaksia e revistës, e cila është nderkombetarisht në Scopus. Poashtu thekson që standardet e citimit dhe metodologjia e përdorur është ashtu siq e aplikon kjo revistë sepse punimi i është nënshtruar recensionit nga ana e editorëve të revistës"

➤ Me datën 30 Nëntor 2021, Këshilli i Etikës ka pranuar përgjigjen e ORCA-s ndaj përgjigjes së Prof. dr. Bujar Dugolli. Sipas ORCA, profesor Dugolli nuk e mohon përmbajtjen e pjesëve të plagjiaturës në punim për shkak të mungesës së platformës për kontrollim, gjë që e kundërshton ashpër. ORCA kundërshton deklaratën e profesorit dhe sipas kësaj organizate titujt akademik mund të revokohen në çdo kohë dhe shkëputja e kontratës mund të realizohet edhe pse kontrata është valide.

➤ Poashtu me datën 30 Nëntor 2021, organizata ORCA përgjigjet ndaj deklaratës së prof. ass. dr. Ardian Kastrati duke theksuar që:

L. M.

'përgjigja e të denoncuarit Ardian Kastrati nuk është relevante për lëndën e cila është në shqyrtim dhe si rrjedhojë ORCA nuk ka komente të mëtutjeshme për çështjet e ngritura'.

➤ Me datë 17 MAJ 2022, është organizuar seancë dëgjimore për palët e denoncuara në këtë rast. Seanca është mbajtur në prani të anëtarëve të KE, në hapësirat e objektit të Rektoratit. Fillimisht është zhvilluar seanca dëgjimore me Prof. dr. Bujar Dugollin, i cili pohon se gjatë procesit të publikimit të punimit është dashtë të bëhet modifikim prej 6000 në 4000 fjalë, prandaj edhe kanë ndodhur lëshime teknike. Poashtu ai pohon se punimi në fjalë është REVIEW, dhe nuk ka qenë botim që ka krijuar numrin e caktuar të punimeve për të marrë thirrjen Profesor i rregullt. Gjatë seancës dëgjimore vërtetohet se punimi ende ekziston në databazën Scopus, përkundër që revista e ka larguar nga webfaqja e saj. Prof. dr. Bujar Dugolli pohon se revista për shkak të presionit të ushtruar nga Organizata 'ORCA' është obliguar ta marrë për largimin e punimit nga faqja e tyre.

➤ Gjithashtu Prof.ass. dr. Ardian Kastrati gjatë seancës dëgjimore deklaroi se lëshimet teknike në punim kanë ndodh për shkak se revista ka kërkuar disa herë zvogëlimin e numrit të fjalëve. Prof.ass. dr. Ardian Kastrati deklaroi se sulmi ndaj tij ka të bëjë me qëndrimet e tij politike dhe aspak me punën e tij akademike.

III. Baza juridike e vendimit nga ana e Këshillit të Etikës

- Këshilli i Etikës, i formuar me vendimet e Senatit, nr. 4/42, datë 31.12.2020, vendimit nr. 19.02.2021 dhe vendimit nr. 771, datë 12.05.2021, ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të zhvilluar procedurën për çështjet e paraqitura me denoncim dhe edhe për të vendosur meritorisht. Këshilli i Etikës vepron me objektivitet dhe paanshmëri duke zbatuar rreptësisht kornizën normative të UP dhe standardet më të avancuara për sigurimin dhe promovimin e një ambienti akademik të qetë, të dinjitetshëm dhe profesional.
- Këshilli i Etikës është trup i pavarur i UP, i cili udhëhiqet nga sidomos këto akte juridike:
 - Statuti i UP, i nxjerrë në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;
 - Kodi i Etikës i stafit akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nr. 1/751, datë 19.07.2013;
 - Rregullore pune e Këshillit të Etikës, nr. 1/629, datë 14.07.2016;
 - Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP, nr. 857, datë 11.04.2017 si dhe
 - Rregulloren për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual dhe ngacmimi në UP, nr.752, datë 11.05.2021.

L. M.

- Për sigurimin e rreptë të parimeve universale për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe të personelit akademik, ruajtjen e imazhit të UP dhe respektimin rigoroz të rregullave fundamentale për zhvillimin e procedurës në mënyrë profesionale dhe të paanshme, Këshilli i Etikës ka adaptuar në vazhdimësi rregulla drejtuese dhe praktika të standardizuara për çështje procedurale dhe si të tilla konsiderohen rregulla normative për zhvillimin e procedurës para Këshillit të Etikës.

IV. Të gjeturat dhe kualifikimi juridik

- Këshilli i Etikës ka zhvilluar procedurën duke u bazuar në kornizën normative sapo të cekur dhe ka arritur në përfundimin si në dispozitiv të vendimit.

1. Aspektet procedurale

- Këshilli i Etikës ka zhvilluar procedurën konform kornizës normative duke respektuar me rreptësi parimet fundamentale për një proces objektiv dhe të paanshëm. Këtu mund të theksohen sidomos trajtimi me dinjitet të palës dhe çështjes si dhe sigurimin e parimit të dëgjimit të palës (sidomos dispozitat e nenit 4 Rregullore pune e Këshillit të Etikës, nr. 1/629, datë 14.07.2016).
- Për të siguruar një zhvillim të tillë objektiv, Këshilli fillimisht ka zhvilluar procedurën e komunikimit të shkresave me palët dhe pastaj trajtimin e çështjes në seancë. Për shqyrtimin e kësaj çështje, Këshilli i Etikës ka organizuar disa seanca dhe ka arritur në përfundimin se thirrja e palës në seancë është e nevojshme, edhe pse faktet e prezantuara nuk kanë qenë shumë të kontestueshme sa i përket hulumtimit shkencor, i cili ka qenë objekt trajtimi në këtë procedurë (sidomos dispozitat e nenit 4, 5, 6 të Rregullores pune të Këshillit të Etikës, nr. 1/629, datë 14.07.2016).
- Këshilli i Etikës ka konstatuar se mund të nxjerr vendim meritore dhe se ky vendim mund të konsiderohet vendim i organit të shkallës së parë, kundër të cilit mund të paraqitet ankesë në organin e shkallës së dytë dhe atë në Senatën e UP, si organ i shkallës së dytë brenda Universitetit, me të cilin edhe përfundon procedura brenda UP. Palë e legjitimuar për ankesë kundër këtij vendimi është edhe pala denoncuese edhe pala e denoncuar. Rruga juridike për trajtim të çështjes jashtë UP është e siguruar sipas rregullave përkatëse juridike dhe të cilat rregulla vlejnë pa kufizime edhe për raste dhe vendime të tilla (praktikat e standardizuara edhe në bazë të nenit 11 par. 5 dhe 6 i Rregullores nr. 752, datë 11.05.2021).

2. Aspektet materiale

- Këshilli i Etikës ka konstatuar në procedurën e këshillimit dhe të votimit përtej çdo dyshimi të bazuar (neni 7 par. 3 i Rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj

L. M.

personelit akademik të UP, nr. 857, datë 11.04.2017) se i denoncuari, me publikimin e këtij artikulli ka cenuar rregullat etike të parapara me kornizën normative të UP-së.

- Këshilli i Etikës konsideron se fakti i largimit të këtij publikimi nga revista është fakt i pakontestueshëm se artikulli i botuar nuk i ka përmbushur standardet akademike dhe shkencore për t'u botuar në një revistë me kredibilitet ndërkombëtar.
- Këshilli i Etikës ka marrë parasysh gjithashtu Rregulloren për Masat dhe Procedurat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës (875, 11.04.2017) e cila thotë se paraqitja e punimeve të tjerëve si të vetat përbën *Shkelje e rëndë e të drejtës së autorit dhe etikës në publikimet shkencore* (neni 1.15.).
- Këshilli i Etikës ka marrë parasysh edhe nenin 10 të Kodit të Etikës ku thuhet se “Hulumtim dhe dije-sjellje e papranueshme” konsiderohet *Shkelja e standardeve të ndershmërisë intelektuale, të tilla si sjellja e pahijshme dhe/ose keqpërdorimi i qëllimshëm i shkrimeve, hulumtimeve dhe gjetjeve të tjerëve.*
- Këshilli i Etikës është bazuar gjithashtu në definicionet e shumta relevante të asaj që konsiderohet plagjiaturë, të tilla si ajo e Universitetit të Oksfordit ku thuhet se: *Plagjiatura është paraqitja e punës ose ideve të dikujt tjetër si tuajat, me ose pa pëlqimin e tij, duke e përfshirë atë në punën tuaj pa e njohur plotësisht. I gjithë materiali i botuar dhe i pabotuar, qoftë dorëshkrim, qoftë i shtypur apo në formë elektronike, mbulohet nga ky përkufizim. Plagjiatura mund të jetë e qëllimshme, nga pakujdesi ose e paqëllimshme. Sipas rregulloreve për ekzaminimet, plagjiatura e qëllimshme ose nga pakujdesi është një shkelje disiplinore.”* ([Plagiarism | University of Oxford](#))
- Pretendimi i të denoncuarit se plagjiatura është shfaqur si rrjedhojë e shkurtimit të tekstit për respektimin e standardit të numrit të fjalëve është i paqëndrueshëm.
- Këshilli i Etikës ka arritur në përfundimin duke u bazuar në kuadrin normativ të UP dhe duke shqyrtuar çdo çështje në mënyrë augmentative, se masa e shprehur në dispozitivin e vendimit është e bazuar, është e drejtë dhe është proporcionale (sidomos dispozitat e nenit 6 dhe 7 par. 10 të Rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP, nr. 857, datë 11.04.2017). Si rrethanë rënduese është marrë fakti se i denoncuari ka qenë në dijeni ose do të duhej të ishte në dijeni se një artikull i tillë nuk i plotëson standardet shkencore dhe akademike për botim. Një fakt i tillë e cenon kredibilitetin e Universitetit të Prishtinës karshi autorëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Këshilli i Etikës ka marrë në konsideratë si rrethanë lehtësuese faktin se Prof. Kastrati ka shprehur keqardhje për situatën e krijuar lidhur me këtë publikim.

V. Vendimi

- Këshilli i Etikës ka vendosur njëzëri si në dispozitiv të vendimit duke marrë për bazë autoritetin e legjitimuar për vendosje, duke shqyrtuar të gjitha rrethanat e rastit, në tërësinë e tyre faktike dhe normative si dhe duke u bazuar në kuadrin normativ përkatës të UP.

VI. Këshilla juridike

- Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtën e paraqitjes së ankesës në Senatin e UP brenda afatit prej 30 ditësh pas pranimit të këtij vendimi. Ankesa mund të paraqitet për vendosje në Senatin akademik nëpërmjet Këshillit të Etikës dhe atë nëpërmjet mailit, dorëzimit të deklaratës me shkrim në Rektorat ose nëpërmjet postës apo dhënien e deklaratës verbalisht në zyrat e Rektoratit.

Në emër dhe me autorizimin e Këshillit të Etikës



Prof. Dr. Iset Morina
Kryesues